

ANA LALAJ

**SHQIPËRIA DHE PROJEKTET  
E (KON)FEDERATAVE BALLKANIKE  
(1941-1945)\***

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ballkanet zunë një vend të rëndësishëm në planet ushtarake dhe në diplomacinë e Luftës. Kjo jo vetëm se jeta e 80 milion njerëzve në Ballkanë ishte në rrezik, por dhe për pozitën gjeostrategjike të rëndësishme në kryqëzimin e rrugëve detare dhe tokësore ndërkontinentale të vendeve ballkanike.

Që në vitin 1939, Britania e Madhe ishte mjaft e përfshirë në parashikimin e kufijve të rinj të pasluftës të Evropës Lindore e Qendrore. Në literaturën historiografike është i njohur kontributi që ka dhënë për Evropën Juglindore Qendra e “Kërkimeve Shkencore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shërbimin e Medias” (Foreign Research and Press Service - FRPS) në Oksford, e kryesuar nga historiani i shquar britanik Arnold Toynbee. Objekt i kryesor i këtij ekipi u bënë popujt dhe vendet që shtriheshin midis Gjermanisë në Perëndim dhe Rusisë në Lindje, dhe nga Balltiku në veri e deri në Mesdhe dhe Adriatik në jug. Qeveria Britanike i ngarkoi kësaj qendre detyrën për të studiuar të ardhmen e EJT, mbështetur në dokumentet historike. Zgjidhja që ekipi i mësipërm ofroi ishin konfederatat multinacionale,<sup>1</sup> ku njëra prej tyre do të ishte *Konfederata Danubiane*, e cila do të shtrihej në veri, dhe do të përfshinte Poloninë, Çekosllovakinë, Austrinë, Hungarinë; kurse e dyta do të ishte *Konfederata Ballkanike*, e cila do të shtrihej në jug, e do të përfshinte Jugosllavinë, Bullgarinë, Greqinë, Shqipërinë dhe mundësisht edhe Rumaninë.

Koncepti i federatës multinacionale imponohej nga siguria nacionale, historikisht e rrezikuar e shteteve të vegjël të Evropës Juglindore. Por edhe në pikëpamje ekonomike, secili prej tyre kishte qenë një barrë për shtetet evropiane perëndimore, pavarësisht nga disa përfitime të pjesshme. Për të kapërcyer këtë situatë, zgjidhja do të ishte vetëm një shtet multinacional, ku institucionet federale të kombinuara me autonominë lokale, sëbashku do të

---

\* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 26 nëntor 2009.

<sup>1</sup> *Pax Britanica, Wartime Foreign Office Documents Regarding Plans for a Postbellum East Central Europe*, Ed. Andras D. Ban, New York: 1997, f. 111.

krijonin një shtet të madh, tolerant, të aftë të mbështeste veten kundër një agresioni gjerman të rinovuar dhe të përballonte sfidat ekonomike. Këto konfederata që të bëheshin efektive do të kishin jo vetëm vullnetin e qeverive vendase, por edhe mbështetjen ekonomike, politike dhe diplomatike të Britanisë së Madhe, SHBA dhe BS. Nga studimet, nënkuptohet që orientimi i tyre anglo-sakson do të ishte prioritet. Shumë shpejt, sugjerimet e Qendrës së “Kërkimeve Shkencore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shërbimin e Medias” për këtë rajon të Evropës u bënë politikë zyrtare e Britanisë së Madhe.

Hapat e parë në vijim të kësaj politike u hodhën në vitin 1941, kur qeveria britanike organizoi një varg takimesh me përfaqësuesit e qeverive legjitime të vendeve të Evropës Juglindore në emigracion në Londër, pavarësisht se nuk kishte siguri, që këto qeveri do të ktheheshin në pushtet pas luftës. Rezultati ishte nënshkrimi i Paktit greko-jugosllav, më 15 janar 1942 dhe i Paktit çekoslovakopolak, 8 ditë më vonë, më 23 janar 1942. Në Paktin grek-jugosllav të nënshkruar nga mbreti i Greqisë, Tsouderos, dhe mbreti i Jugosllavisë, Slobodan Jovanović, sanksionohet bashkimi i Greqisë me Jugosllavinë, si bërthamë për organizimin e Bashkimit të ardhshëm Ballkanik. Parimi politik i këtij bashkimi ishte “Ballkani për popujt ballkanikë”.<sup>2</sup> Bashkimi Greko-jugosllav do të kishte organin e vet politik, ekonomik dhe ushtarak. Marrëveshja do të ratifikohej nga parlamentet përkatëse sa më shpejt të qe e mundur. Përfaqësuesit e të dy palëve nënshkruese (jugosllave dhe greke) deklarorin se ata do të ndërtonin konfederatën e pas Luftës, e cila do të ishte e lirshme dhe e hapur për vendet e tjera të rajonit.

Nënshkrimi i Paktit greko-jugosllav, vinte menjëherë pas nënshkrimit të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara Antifashiste, nga përfaqësuesit e qeverive në emigracion, më 1 janar 1942. Të dy këto dokumente e shqetësuan mbretin Zog, i cili në atë kohë ndodhej në Londër me statusin e një qytetari privat. Në optikën e tij, mungesa e firmës së përfaqësuesit shqiptar në këto dy dokumente, do të thoshte se Shqipëria do të lihej jashtë rregullimeve të rëndësishme ballkanike dhe botërore. Ai i shtoi përpjekjet te qeveria Britanike dhe ajo Amerikane për t’u njohur statusi i tij si Kryetar i shtetit shqiptar. Për këtë bëri një lëvizje dhe nga Stambolli, ku përfaqësuesi diplomatik shqiptar, u kërkonte qeverive amerikane dhe britanike të deklaroheshin për pavarësinë e Shqipërisë.<sup>3</sup>

Për ironi të përpjekjeve të mbretit Zog, deklarata e tre Aleatëve të Mëdhenj u lëshua në dhjetor 1942, por në të, përveçse shprehej vullneti i tyre për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, pohohej edhe se forma e regjimit do të vendosej nga “vullneti i popullit shqiptar pas Luftës...” dhe “...nuk

<sup>2</sup> L.S. Stavrianos, *Balkan Federation. A History of the Movement Toward Balkan Unity in Modern Times*, Hamden, Connecticut: “Archon Books”, 1964, f. 311.

<sup>3</sup> *National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), Roll 1, 875.01/406.

paragjykoheshin rregullimet që Shqipëria mund të bënte me shtete të tjerë të Ballkanit”, gjë që do të thoshte se kreditet e Zogut si mbret i Shqipërisë kishin rënë.<sup>4</sup>

Ndërsa nacionalistët shqiptarë brenda vendit, frikën ndaj Paktit greko-jugosllav do ta shprehnin në një mënyrë të vetën, sa mosbesuese aq edhe egocentriste. Në një telegram dërguar Churchillit dhe Idenit më 18 janar 1944, Muharrem Bajraktari do të shkruante: “Kjo konfederatë (FB) duhet të ndërtohet me ndihmën e Kombeve Aleate mbi bazën e nacionalizmit dhe në asnjë mënyrë mbi bazën e supremacisë sllave. Pikënisja për nacionalizmin në Ballkan duhet të gjendet në mes të popullit shqiptar dhe ky popull do të marrë iniciativën për zgjerimin.”<sup>5</sup>

Meqenëse krijimi i konfederatave ishte një eksperiment, ku shumë çështje ishin të paqarta dhe shumë probleme ishin të pazgjidhura, ekipi i “Kërkimeve Shkencore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shërbimin e Medias” kreu një varg studimesh ku u prekën problemet e kufijve midis shteteve anëtare, nëse ata do të ishin të përhershëm apo të përkohshëm e fleksibël; problemet e minoriteteve, strukturat e përbashkëta ekonomike, politike, ushtarake, pra parë në përgjithësi, avantazhet dhe disavantazhet ekonomike dhe politike të vendeve që merrnin pjesë në këto konfederate. Për të gjitha propozimet britanike, ishte parashikuar dhe përgjigja potenciale e BS.

Në studimet për konfederatën Ballkanike, një vend të veçantë zuri edhe Shqipëria.<sup>6</sup> Sipas studimeve, Shqipëria ishte strategjikisht jetësore për Konfederatën e Jugut, me pozicionin e saj të rëndësishëm në Adriatik. Por njëkohësisht Shqipëria ishte tepër e dobët dhe e prapambetur dhe kjo krijonte probleme për sigurinë e Konfederatës. Ajo kishte probleme kufitare me fqinjët e saj, Greqinë dhe Jugosllavinë, armiqësia e të cilëve kishte arritur deri në projekte dhe veprime për copëtimin e saj. Por në qoftë se do të lejohej ky copëtim, do të dhunoheshin parimet e Kartës së Atlantikut, ku të dy shtetet ishin nënshkrues. Prandaj studiuesit britanikë nxirrnin konkluzionin se përfshirja e Shqipërisë në Konfederatën e planifikuar është e vetmja zgjidhje e drejtë, pavarësisht nga vështirësitë që krijon ajo. Dhe nëse ajo nuk do të ishte anëtare e asnjë bashkimi, atëherë vetëm një formë speciale e ndihmës prej ekspertëve dhe këshilltarëve Perëndimorë mund ta kursente atë prej ndarjes ndërmjet fqinjëve të saj.

Studimet analizojnë hollësisht kufijtë e Shqipërisë si anëtare e Federatës. Kufijtë shqiptaro-jugosllavë të para-1939 kishin lënë në Jugosllavi më shumë se ¼ e popullsisë shqiptare në tërësi, ndanë fiset shqiptare prej qyteteve

<sup>4</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 684.

<sup>5</sup> Reginald Hibbert, *Fitorja e Hidhur (Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë)*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f. 379.

<sup>6</sup> *Pax Britanica, Wartime Foreign ...*, f.43-44.

tradicionalë të tregut dhe disa qytete në Jugosllavi mbetën të dobët prej inkursioneve sulmuese nga Shqipëria. Nga ana tjetër, shumica e rajoneve shqiptare në Jugosllavi kishin shkëputur lidhjet ekonomike tradicionale me pjesën tjetër të Shqipërisë. Prandaj studimi propozonte “një vijë kompromisi, ... e cila mbështetet në heqjen e kufijve etnike, ... por duke lejuar, që të krijohen kontaktet ekonomike përmes tyre, me anë të rregullimeve të brendshme të Konfederatës”.<sup>7</sup>

Për sa i përket kufirit shqiptaro-grek, konstatohet se ai ishte gjithashtu i debatuar ashpër prej shumë vitesh, pasi Shqipëria ka kërkesa për Greqinë e Veriut dhe Greqia ka kërkesa për Shqipërinë e Jugut. Por sipas studiuesve britanikë, kënaqja e kërkesave greke plotësisht, do të shkëpuste nga Shqipëria rajonet më të civilizuar, ato me të cilat ishin lidhur shumica e emigrantëve shqiptarë. Gjithashtu kjo do të zvogëlonte burimet shqiptare kaq shumë, sa ajo ndoshta nuk do të ishte në gjendje të mbijetonte.

Është për t'u shënuar se në studimet e mësipërme, problemi i kufirit nuk ishte vetëm territorial por edhe etnik. Në to theksohet se si në gjithë Ballkanet, edhe në kufirin shqiptaro-grek, është e pamundur të vendosësh për një kufi etnik të arsyeshëm. Askush nuk mund të thotë me siguri nëse banorët e rajoneve të debatueshme janë grekë të shqiptarizuar apo shqiptarë të helenizuar. Ndërsa një plebishit për të zbuluar dëshirat e tyre do të jetë me vlera të diskutueshme për shkak të karakterit primitiv të popullsisë, pasioneve tashmë të ngritura, dhe, pasigurisë, e cila do të ekzistojë, madje edhe kur do të mbahet plebishiti për mbijetesën e Shqipërisë.

Prandaj studiuesit britanikë supozonin që kufiri i 1939 (i paraluftës) nuk duhej të ndryshonte, me qëllim që të mos i shkakohej dëm as Shqipërisë e as Greqisë. “Pothuajse çdo kufi këtu, përfundon Memorandumi, do të shkaktojë probleme të tregut dhe komunikimit, por le të shpresohet që rregullimet konfederaliste do t'i minimizojnë këto”.<sup>8</sup>

Për propozimet e saj për Konfederatat e Evropës Juglindore, qeveria britanike përgatiti dhe një material zyrtar të titulluar: “E ardhmja e Polonisë, e vendeve të Danubit dhe të Ballkanit”, të cilin e paraqiti në Konferencën trepalëshe në Moskë, mbajtur më 18 tetor deri më 1 nëntor 1943. Ministri i jashtëm Sovjetik, Molotov, paraqiti një deklaratë,<sup>9</sup> sipas së cilës këto federata të planifikuara nga lart dhe teorikisht, konsideroheshin “krijesa artificiale”; vendet e vogla të sapoçliruara “kërkojnë kohë për tu përshtatur me situatën e re, fqinjët dhe shtetet e tjera”, dhe së fundi theksohet se “Mbi të gjitha, disa nga planet për federatat i kujtojnë popullit sovjetik politikën e “*kordonit sanitar*”, të drejtuar

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 44.

<sup>8</sup> *Pax Britanica, Wartime Foreign ...*, f.71.

<sup>9</sup> *Foreign Relations of the United States, Diplomatic Papers, 1943*, Volume I, General. Washington: “United States Government Printing Office”, 1963, f. 639.

siç dihet, kundër Bashkimit Sovjetik, dhe prandaj (konfederatat) konsiderohen të pafavorshme për popullin sovjetik”.<sup>10</sup>

Pas kësaj deklarate, ministri i Jashtëm britanik Iden (Eden), shpjegoi se “qeveria britanike është shumë e interesuar të krijojë një kordon sanitar ndaj Gjermanisë, ... por vështirë të thuhet se e njëjta gjë do të ishte e dëshirueshme edhe ndaj BS.... Dhe meqë Zoti Molotov këmbëngul, ai tërheq propozimin e tij”.<sup>11</sup>

Një muaj më vonë, në konferencën e Teheranit, më 28 nëntor-1 dhjetor 1943, ideja e federatës ballkanike dhe çdo federate tjetër u braktis, pasi siç shprehen dokumentet përfundimtare të konferencës, “BS ka kundërshtuar me forcë krijimin e çdo konfederate në Lindje, Juglindje dhe Evropën Qendrore, për arsyt që u paraqitën në konferencën e Moskës”.<sup>12</sup>

Në konferencën e Teheranit u vendos që krijimi i federatave të përfshihej ndër ato probleme politike që do të trajtoheshin dhe do të zgjidheshin pas Luftës. Vendimet për problemet e pasluftës, që ishin marrë nga qeveritë legjitime në mërgim, nuk do të kishin më fuqi. Fati i vendeve të Evropës Qendrore e Lindore kaloi përfundimisht nga këto qeveri në duart e tre Aleatëve të Mëdhenj, të cilët në Teheran morën përsipër të merrnin vendime të përbashkëta, dhe madje në emër të të gjithë aleatëve antifashistë. Ky ishte ndryshimi i madh që ndodhi në Teheran, ku tre të mëdhenjtë, Ruzvelt, Stalin dhe Churchill u takuan për herë të parë me njëri tjetrin.

Pas kësaj ekipi i Institutit për “Kërkime Shkencore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shërbimin e Medias” në Oksford, i drejtuar nga Arnold Toynbee u shkri dhe u bashkua me Departamentin Shkencor të Foreign Office.

Por ndërkohë që Aleatët i mbyllën kombinacionet për federatat në Evropën Juglindore, të paktën deri në fund të Luftës, në Ballkan kishte filluar të fermentohej një tjetër lëvizje federaliste. Në vitin 1943, J.B.Tito, drejtuesi i Luftës NÇI në Jugosllavi, vlerësoi se Jugosllavia zë vendin udhëheqës në Ballkan si në pikëpamje ushtarake (me 22 divizione), ashtu dhe në atë politike (me këshillat NÇI dhe antifashiste). Si hap të parë për të afirmuar rolin e Jugosllavisë, por edhe të tij si lider i Ballkanit, Tito dërgoi në Maqedoni, në pranverë të 1943, S.V.Tempon, një nga drejtuesit më të lartë të Shtabit Suprem Ushtarak të Jugosllavisë. Tempo u propozoi drejtuesve të lëvizjes komuniste në Shqipëri, Bullgari dhe Greqi krijimin e një Shtabi Ushtarak Ballkanik, të përbërë nga “përfaqësuesit ushtarakë dhe politikë më të respektuar, e të caktuar në mënyrë të pavarur nga secili vend ballkanik”, Ky Shtab do të udhëhiqte

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 762.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *Foreign Relations of the United States, Diplomatic Papers, The Conferences at Cairo and Teheran, 1943*, Washington: “United States Government Printing Office”, 1961, f. 843.

“luftën e popujve të Ballkanit për çlirimin e tyre kombëtar dhe sigurimin e pushtetit demokratik popullor në të gjitha vendet e Ballkanit ... dhe do t'i shërbente afrimit dhe dëshirës për vëllazërimin e vendeve të Ballkanit”.<sup>13</sup> Por pavarësisht nga retorika, synimi i vërtetë ishte që nëpërmjet Shtabit Ballkanik, jugosllavët të rregullonin në detaje qëndrimin ushtarak dhe më pas, atë politik në Shqipëri, Greqi dhe Jugosllavi.<sup>14</sup>

Udhëheqësit komunistë shqiptarë të ndodhur nën ndikimin jugosllav, e përkrahën idenë e një Shtabi të përhershëm suprem të ushtrive nacionalçlirimtare të Ballkanit (në ndryshim nga ç'shkruan Enver Hoxha në kujtimet e tij).<sup>15</sup> E. Hoxha caktoi Koçi Xoxen, atëherë një nga sekretarët e KQ të PKSh, të ishte prezent në të gjitha mbledhjet për Shtabin Ballkanik që do të organizonte Tempo në Greqi dhe Bullgari. Ndërsa përfaqësuesit bullgarë dhe ata grekë e shtynë miratimin e krijimit të Shtabit Ballkanik. Ata u trembeshin synimeve jugosllave në Maqedoni, unifikimi i së cilës brenda Jugosllavisë, e në kurriz të kërkesave territoriale greke dhe bullgare, ishte duke u popullarizuar herë pas here nga drejtuesit jugosllavë.

Të dy palët kishin frikë nga predominimi i Jugosllavisë në Ballkan. Gjatë një takimi me Tempon në fund të gushtit 1943 në një fshat pranë Larisë në Thesali, Georgios Siantos, Zv/Sekretar i përgjithshëm i PKG, vinte re se nuk kishte kaluar shumë kohë që nga shpërbërja e Kominternit (maj 1943) për të filluar së menduari për një Shtab që mund të konsiderohej një lloj “internacionaleje ballkanike”.<sup>16</sup>

Rezistenca e drejtuesve bullgarë dhe grekë, si dhe vendimet e Teheranit në nëntor 1943, bënë që Tito, në dhjetor 1943, të urdhëronte Tempon për të abandonuar të gjitha planet për Shtabin Ballkanik si “gabim fundamental”.<sup>17</sup> Në një letër dërguar Tempos, ai tërhoqte vëmendjen se në “situatën e tanishme ndërkombëtare, por dhe këtu në Ballkan, nuk ka asnjë arsye që shkon në favor të kësaj ideje... Shtabi Ballkanik, i cili po shihet se është nonsens, sepse një i tillë nuk ekziston dhe, nuk mund të ekzistojë (me 4 komandantë dhe 4 komisarë), në fakt do të zmbropste Luftën tonë NÇI, Shtabin Suprem dhe

<sup>13</sup> Svetozar Vukmanović, *Struggle for the Balkans*, London: “Merlin Press”, 1990, f. 90.

<sup>14</sup> Ivo Banac, *With Stalin Against Tito*, Ithaca and London: 1988, f. 29-30.

<sup>15</sup> Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë: 1982, f.47-57.

<sup>16</sup> I. Banac, *vep. e përm.*, f. 31, përmendur sipas Svetozar Vukmanović, *vep. e përm.*, f. 119.

<sup>17</sup> *Sabrana Djela*, Vëll. 18, Belgrade: 1984, f. 18.

“Shtabi Ballkanik”, i shkruante Tito -Tempos në 6 dhjetor 1943, “i cili siç neve mund ta shikojmë, është një budallallëk, sepse ai nuk mundet dhe nuk mund të ekzistojë (me 4 komandantë dhe 4 komisarë) dhe do të tërhoqte pas Luftën tonë Nacionalçlirimtare, Shtabin Suprem dhe AVNOJ me disa lloje të lëvizjes Pan-Ballkanike, e cila nuk është madje aq e kristalizuar edhe gjatë luftës”.

AVNOJ nga njëfarë lëvizje panballkanike, e cila as për së afërmi nuk u kristalizua në procesin e Luftës.”<sup>18</sup> Pas kësaj, Tempo mori përsipër përgjegjësinë duke deklaruar se Shtabi Ballkanik ishte një krijesë e tij.<sup>19</sup>

Më 29 nëntor 1943, në mbledhjen e II të AVNOJ-t (Këshilli Antifashist Nacional çlirimtar i Jugosllavisë), Tito pa e lajmëruar Stalinin, realizoi ngrehinën e Federatës Jugosllave. Dëshmitarët e kohës tregojnë se Stalini u nervozua shumë kur u informua për krijimin e Federatës jugosllave, dhe e quajti atë “Goditje pas shpinës së BS dhe vendimeve të Teheranit”.<sup>20</sup> Megjithatë as Perëndimorët nuk u ndjenë, jo thjesht se Tito i kishte vënë ata përpara faktit të kryer, por dhe se deklarata e shpallur përfshinte territoret dhe popujt e Mbretërisë Jugosllave të paraluftës. Vendimi për përfshirjen e Istrias dhe rajoneve të tjera me popullsi sllovene në Itali u mbajt i fshehur nga udhëheqësit komunistë jugosllavë.<sup>21</sup> Stalini e përshëndeti atë vetëm më 14 dhjetor 1943, ku në komunikatën botuar në PRAVDA, deklaroi se kishte pasur “një përgjigje të favorshme nga Britania dhe SHBA”.<sup>22</sup>

Por Federata jugosllave ishte e pamjaftueshme për Titon, që synonte të bëhej Çezari i Ballkanit. Këtë e dëshmon edhe intervista e Ministrisë të Jashtëm të Jugosllavisë, Josif Smodllaka, dhënë gazetarit amerikan C.L. Sulzberger, në prill 1944, ende pa mbaruar lufta: “*Qëllimi ynë i parë*, deklaronte Smodllaka, është një Jugosllavi federative e lirë. Por kjo nuk është mjaft për të siguruar paqen në Ballkanë. Ne duhet të kemi një Federatë Ballkanike dhe hapi i parë do të jetë një bashkim i Jugosllavisë dhe i Bullgarisë. *Hapi i dytë*, ne do të ftojme Shqipërinë të hyjë në të, me të drejta të plota dhe të barabarta. Atëherë ne do të jemi mjaft të fuqishëm për të përballuar çdo sulm prej çdo ane qoftë”.<sup>23</sup>

Viti 1944 do të shënonte suksese të Ushtrisë së Kuqe në frontin e luftës, i cili po shtyhej gjithnjë e më shumë drejt Evropës Lindore dhe Ballkanëve. Gjithashtu, partitë komuniste në këto vende i kishin shtuar radhët dhe autoritetin e tyre. Viti 1944 do të shënonte suksese të Ushtrisë së Kuqe në frontin e luftës, i cili po shtyhej gjithnjë e më shumë drejt Evropës Lindore e Ballkanëve. Gjithashtu, partitë komuniste në këto vende i kishin shtuar radhët dhe autoritetin e tyre. Churchill, i cili i pari e kishte kuptuar rrezikun e komunistizimit të Ballkanit, më 12 gusht 1944 takoi Titon në Napoli dhe i

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> S. Vukmanović, *vep e përm.*, f. 67.

<sup>20</sup> Vladimir Dedijer, *Dokumenti 1948*, Beograd: 1979, f. 15.

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 21.

<sup>22</sup> Slobodan Nešović, *Jugosllav Bulgarian Relations*, Skopje: 1979, f. 220.

<sup>23</sup> *British Documents on Foreign Affairs: Reports and Papers from the Foreign Office Confidential Print*. General editors Paul Preston & Michael Partridge, Part III, From 1940-1945, Series F EUROPE, Volume 23, University Publication of America, 1996.

drejtoi atij pyetjen: A e dëshironi Federatën Ballkanike? Tito iu përgjigj: Jugoslovensku Federaciju...,<sup>24</sup> që në gjuhën serbokroate ka kuptim të dyfishtë, “Federatën jugosllave” ose “Federatën e sllavëve të jugut”. Në kuptimin politik, federata jugosllave nënkuptonte federatën e krijuar në nëntor të vitit 1943, kurse federata e sllavëve të jugut nënkuptonte shumë më tepër, bashkimin e popujve sllavë në Ballkanë. Tito iu shmang përgjigjes së drejtpërdrejtë, por për Çurçillin aq sa dëgjoi ishte e mjaftueshme për të kuptuar fuqizimin e forcave të majta në Ballkanë dhe bashkëpunimin e tyre për bashkim. Më pas ai u fluturoi në Moskë për të shpëtuar aq sa mund të shpëtohej nga procesi i komunistizimit të Ballkanëve. Në tetor 1944, në Moskë, ai kalkuloi me Stalinin marrëveshjen më të jashtëzakonshme, atë që në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare njihet si “Marrëveshja e përqindjeve”, ose “Ndarja e sferave të influencës”.

Në këto rrethana premtuese, Stalini i rekomandon Dimitrovit që qëndronte akoma në Moskë si emigrant, që të fliste me Titon për bashkimin e Ballkanëve në një Federatë. “Ju duhet ta mbështesni atë”,<sup>25</sup> i tha Stalini Dimitrovit. Ky i fundit e takoi Titon dhe i përcolli mesazhin e Stalinit. Menjëherë në Beograd u hartua një projekt për federatën jugosllave-bullgare, dhe një delegacion me në krye Kardelin u dërgua në nëntor të vitit 1944 në Sofje. Sipas Projektit, marrëveshja do të nënshkruhej më 31 dhjetor 1944 dhe Federata do të shpallej më 1 janar 1945. Për të ishin bërë gati sallat ku do të zhvilloheshin kremtimet, oratorët, madje dhe një ndërtesë zyrtare, ku do të qëndronin institucionet më të larta të Federatës.<sup>26</sup> Ndërsa në Sofje ishte përgatitur gjithçka, deri në detajet më të vogla për nisjen e kryeministrit, ministrit të jashtëm dhe ministrave që përfaqësonin secilën parti në Front për të nënshkruar në Beograd.<sup>27</sup> Ata do të shkonin në kryeqytetin jugosllav me një veturë speciale të Shahut të Persisë që kishte mbetur në Sofje prej shumë vitesh. Madje dhe bagazhet e ministrave ishin paketuar. Në të, sipas Moshës Pijades, atëherë një nga drejtuesit kryesorë të PK Jugosllave, ishte parashikuar edhe një kabinet për Shqipërinë. Por bisedimet nuk vajtën ashtu siç parashikohej. Sipas Sofjes, Federata duhej të ishte dualiste, domethënë një paritet midis Bullgarisë dhe Jugosllavisë, kurse sipas Beogradit, Federata duhej të ishte pluraliste, domethënë, Bullgaria do të ishte e barabartë me secilën nga

<sup>24</sup> *Tito-Churchill*, Editor Dr. Dushan Biber, Arhiv Jugoslavije / Beograd Globus / Zagreb, 1981, f.277.

<sup>25</sup> *Cold War International History Project Bulletin*, Washington D.C.: Issue 10, f. 38.

<sup>26</sup> Branko Petranović, *Balkanska Federacija (1943-1948)*, Beograd: 1991, f. 121.

<sup>27</sup> *Foreign Relations of the United States*, 1945, Volume IV, Europe, Washington: 1968, f. 250.

gjashtë republikat e Jugosllavisë.<sup>28</sup> Për shkak të kundërshtimit bullgar, projekti nuk u miratua dhe jugosllavët përgatitën një projekt të ri, i cili do të diskutohej në Beograd.

Pas dështimit të misionit të Kardelit në Sofje, në fund të 1944, Tito dërgoi një delegacion të Komitetit Kombëtar të Çlirimit të Jugosllavisë të kryesuar nga Andrei Hebrang në Moskë. Në takimin që ai pati me Stalinin më 9 janar 1945, ky i fundit sugjeroi që bashkimi i Jugosllavisë me Bullgarinë duhej të bazohej “në parimin e dualizmit”, ....por drejt tij duhej shkuar “gradualisht”..., “do të kishte qenë mirë të ishte përfunduar një marrëveshje mbi miqësinë e ndihmën reciproke për 20 a 10 vjet”....Stalini u shpreh se bashkimi do të ishte “një epokë në historinë e Evropës”. Ndërsa për Shqipërinë, Stalini do të paralajmëronte se me të duhej pasur kujdes..., se “nuk ia vlen të luftosh me Anglinë”,<sup>29</sup> gjë që shprehte statusin ndërkombëtar delikat dhe ende të papërcaktuar të Shqipërisë.

Ndërkohë që Moska bënte presion për një federatë jugosllave bullgare dualiste, më 2 janar 1945, ambasada britanike në Washington lajmëronte Departamentin e Shtetit se “ka shenja se po shqyrtohet ideja e një federate jugosllave bullgare në favor të Lëvizjes Nacional Çlirimtare, se shtypi bullgar ka komunikuar një takim në Beograd midis një delegacioni bullgar dhe atij jugosllav, se përkrahësit e Titos po bëjnë agjitacion për një Maqedoni më të madhe në kurriz të Greqisë, se qeveria e Madhërisë së Saj do të mirëpriste një federatë ballkanike ku të përfshiheshin aleatë dhe armiq, madje edhe Turqinë, por nuk mund të jetë në mbështetje të një federate të sllavëve të jugut, që izolon Greqinë dhe rrezikon pozitën e saj si një shtet Ballkanik; dhe se Bullgaria synon me këtë federatë t’u shpëtojë konsekuencave që rrjedhin si një shtet i cili në dy luftëra Botërore është bashkuar me Gjermaninë kundër fqinjëve ballkanikë dhe Perëndimit”.<sup>30</sup>

Departamenti i Shtetit iu bashkua po atë ditë pikëpamjes britanike duke pohuar se “Federata e Sllavëve të Jugut në rrethanat aktuale do të ishte vetëm një faktor destabilizimi në Evropën Juglindore, sepse shtetet jo sllave të Ballkanit, duke përfshirë edhe Turqinë do ta konsideronin atë një kërcënim të sigurisë së tyre.”<sup>31</sup>

<sup>28</sup> NARA, Roll 7, 860h.00/3-1649; *Borba*, 20 janar 1949. Fjalimi i Aleksandër Rankoviçit në kong II PK të Serbisë.

<sup>29</sup> *Vostochnaja Evropa v Dokumentah Rosijskih Arhivov 1944-1953*, Tom I, 1944-1948, dok. 37, Moskva-Novosibirsk, 1997.

<sup>30</sup> *Foreign Relations of the United States, 1945*, Volume V, Europe, Washington 1967, f. 1305.

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 1307.

Pikërisht në këtë situatë, në fund të janarit 1945, përfaqësuesit e Bullgarisë dhe Jugosllavisë papritur u ftuan në Moskë për arbitrimin sovjetik.<sup>32</sup> Tanimë situatat kishin evoluar dhe ideja e federatës u shty për më tej, dhe në vend të saj Stalini kërkoi një traktat miqësie jugosllavo-bullgar. Arsyeja ishte kundërshtimi A-A, pasi Bullgaria ende nuk e kishte nënshkruar Traktatin e Paqes, si vend i mundur. Kështu u mbyll problemi i Federatës së Sllavëve të Jugut, që filloi ende pa mbaruar Lufta.

Se ç'vend do të zinte Shqipëria në atë federatë, dokumentet dëshmojnë se kjo do të varej nga platforma jugosllave. Dhe po të nisemi nga disa deklarata të drejtuesve komunistë shqiptarë për Federatën, të bëra gjatë dhe në vitet e para të pasluftës, midis tyre edhe deklarata e dalë nga Kongresi Antifashist Nacionalçlirimtar i Përmetit, në maj 1944, siç ishte dhe ajo "e vëllazërimit të shqiptarëve me popujt e tjerë liridashës të Ballkanit, në një konfederatë ballkanike, ku popujt të kenë të drejta dhe mundësi të barabarta zhvillimi",<sup>33</sup> mund të themi se ato janë bërë më shumë në kontekst të një ideje romantike, një slogan qarkullues i lëvizjeve antifashiste, se sa një platformë e përpunuar. Ndërsa te jugosllavët, zgjerimi edhe më tej i federatës së tyre, dalë prej AVNOJ-it, ishte një strategji. Që në 16 janar 1945, Tito do t'i deklaronte Maklinit (Brigadier Maclean), komandantit të Misionit Ushtarak Aleat në Shtabin e UNÇL Jugosllave, se "ai ishte shumë më i prirur ndaj një federate më parë me Shqipërinë se sa me Bullgarinë". Por rrjedha e ngjarjeve dëshmoi se Stalini kishte frikë nga federatat e mëdha e të pakontrolluara tërësisht prej tij, në kufij të BS. Megjithatë, pavarësisht nga presioni i Stalinit dhe ai perëndimor, Tito do t'i ecte me zell kësaj rruge, por për të shpjeguar se cilat ishin makinacionet e tij, si u shfaq qëndrimi i dyzuar i udhëheqjes komuniste shqiptare, përse kundërshtuan Perëndimorët dhe BS, kjo kërkon një trajtesë tjetër.

---

<sup>32</sup> I. Banac, *vep. e për.*, f. 30.

<sup>33</sup> *Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar*, botuar prej Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, 1944, f. 33. Në botimet e mëvonshme të *Deklaratës së Kongresit të Përmetit* pasazhi për Federatën Ballkanike nuk është hequr.